



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.30.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË MAMUSHËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndër marr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për t'i kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Mamushës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga Ramadan Gashi (Udhëheqës Ekipi) dhe Selvete Foniqi, anëtare e ekipit.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	9
3 Rekomandimet e vitit paraprak	13
4 Qeverisja e përgjithshme	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Komunës së Mamushës për vitin 2014, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e komunës dhe ekipin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 03/10/2014.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, dëshirojmë të përmendim faktin se asnjë pasuri e komunës nuk ishte regjistruar në SIMFK.

Çështje tjera

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 47,534€ dhe një pagesë të parregullt (12,550€) për një projekt që nuk ishte implementuar.


(SNISA 200/1706: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)


Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, megjithatë sistemi duhet të monitorohet për siguar se kontrollet e brendshme janë në veprim të vazhdueshëm.

Në vazhdim do të prezantohen fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë.

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:





Përgjigja nga Menaxhmenti - auditimi për 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

Ne e marrim si punë të kryer faktin që Kryetari:

- Të diskutoj Raportin e auditimit në Asamblenë Komunale; dhe
- Gjatë muajit Janar/shkurt 2016 të inicioj diskutimet në Asamblenë Komunale lidhur me implementimin e Planit të Veprimit për rekomandimet e auditimit, para se PVF 2015 të jenë dorëzuar në Ministrinë e Financave.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e menaxhmentit të Komunës së Mamushës të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operationale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operationale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato konsiderohen relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetëm ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët, do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurave vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Kryetari i komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), për PVF-të e dorëzuara në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna e Mamushës nuk i ka adresuar gabimet materiale në pasuritë e prezentuara në PVF, pasi që këto pasuri nuk janë regjistruar fare në SIMFK. Po ashtu, komuna kishte keq deklaruar shpenzimet e investimeve kapitale. Pavarësisht kësaj, cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë, ku u identifikuan vetëm një numër i vogël gabimesh jo materiale dhe të gjitha kërkesat e raportimit ishin plotësuar.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejt dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale.*

Theksimi i çështjes

Si theksim të çështjes, dëshirojmë të përmendim faktin se asnjë pasuri e komunës nuk ishte regjistruar në SIMFK.

Çështje tjera

Komuna kishte bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale kishte paguar për mallra dhe shërbime vlerën prej 47,534€ dhe një pagesë të parregullt (12,550€) për një projekt që nuk ishte implementuar.

(SNISA 200/1706 Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes)

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Siç është vënë në pah në Memorandumin e Planifikimit të auditimit të datës 03/10/2014, ne kemi identifikuar rreziqet domethënëse që e përcjellin komunën. Rreziqet domethënëse janë rreziqe të keq deklarimeve materiale që sipas gjykimit tonë, kërkojnë vlerësim të veçantë të auditimit. Këto janë rreziqe të anomalive materiale, të cilat mund të rezultojnë në modifikim të opinionit .

Qasja jonë deri më tani pasqyron reagimin tonë të auditimit, siç shpjegohet në detaje brenda memorandumit të planifikimit të auditimit dhe është përmbledhur si më poshtë.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1- Prezantimi i pagesave nga palët e treta

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne kemi shqyrtuar financimet e projekteve dhe pagesat e bëra për komunën nga ana e donatorëve të jashtëm. Ne kemi konstatuar se Menaxhmenti ka ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e këtij rreziku dhe ka bërë paraqitjen e pagesave nga palët e treta në vlerë prej 27,000€ në PVF.

Rreziku i identifikuar

Çështja 2- Mos regjistrimi i të gjitha pasurive në pronësi të Komunës

Përgjigja dhe të gjeturat e auditimit

Ne i kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive në kontekst të shpenzimeve kapitale për vitin 2014 dhe vitet paraprake. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që vlera e pasurive në PVF të ishte e plotë dhe e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm. Komuna nuk ka asnjë pasuri të regjistruar në SIMFK.

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** - Kryetari duhet të ndërmerr masa për caktimin e zyrtarit të pasurisë. Pas caktimit të zyrtarit, të fillohet menjëherë me regjistrimet e pasurive në pajtim me rregulloren Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive.

Çështja 3- Keq klasifikimi i shpenzimeve në kategoria ekonomike

Përgjigja dhe gjetjet e auditimit

Ne kemi konstatuar se menaxhmenti nuk ka ndërmarrë veprime konkrete në adresimin e këtij rreziku, sepse nga kategoria e investimeve janë kryer pagesa për mallra dhe shërbime prej 47,534€.

Rekomandimi 2 Prioritet i lartë - Kryetari duhet të merr masa që të sigurojë se të gjitha shpenzimet do të procesohen përmes kodeve adekuate ekonomike.

2.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm

Përshkrimi

Komuna duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ajo kishte përmbushur kërkesat raportuese si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore për financimin e shpenzimeve të komunës;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Raportet Operacionale (performancës);
- Draft Plani dhe Plani Përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Raportet e dorëzuar me kohë në Ministrinë e Financave (MF) mbi gjendjen e borxheve; dhe

Ne nuk kemi çështje për të ngritur në lidhje me këto, pasi që komuna i ka përmbushur të gjitha obligimet për raportim të jashtëm dhe afatet kohor.

Në draft PVF kishte pasur nevojë që të bëheshin disa korrigjime financiare për shkak se buxheti final, realizimi i të hyrave vetjake dhe disa shpalosje ishin prezantuar gabimisht. Ne kemi dhënë edhe disa sugjerime të tjera për përmirësime. Më pas, PVF janë përmirësuar. Mirëpo, përkundër përmirësimeve, mangësitë e mbetura janë përshkruar si më poshtë.

Çështja 4: Procesi i përgatitjes së PVF - Prioritet i lartë

E gjetura	<p>Komuna kishte keq deklaruar në PVF shpenzimet e investimeve kapitale, ku nga kategoria e investimeve kishte paguar mallra dhe shërbime në vlerë 47,534€;</p> <p>Komuna kishte bërë pagesë të parregullt në vlerë 12,550€ nga kategoria investime kapitale për një projekt që nuk ishte implementuar; dhe</p> <p>Shënimi 31: Përmbledhje e pasurive jo financiare kapitale, totali i pasurive me vlerë mbi 1,000€ në PVF ishte zero.</p>
Rreziku	<p>Paraqitja jo e saktë e PVF dhe gabimeve të identifikuara në shumat e regjistruara, shpie në një keqkuptim të pozitës financiare të komunës dhe ka ndikim potencial negativ në saktësinë e kërkesave të ardhshme buxhetore.</p>
Rekomandimi 3	<p>Kryetari duhet të sigurojë që procesi i prodhimit të PVF-ve plotësisht adreson dobësitë e identifikuara. Deklarata e bërë nga Kryetari dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të dorëzohen në MF duhet të nënshkruhet vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës nga ana e menaxhmentit në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e PVF-ve.</p>

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna kishte përgatitur dhe dorëzuar një plan për adresimin e rekomandimeve nga viti paraprak. Megjithatë, vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2013 të Komunës përmbante 12 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2014, 1 (një) rekomandim ishte adresuar plotësisht, 6 (gjashtë) ishin adresuar pjesërisht, dhe 5 (pesë) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Çështja 5- Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

- E gjetura** Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar, sepse komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet financiare kyçe kanë rezultuar në problemet e njëjta sikurse në vitin e kaluar, si: regjistrimi i pasurive në SIMFK, vonesa në përmirësimin e kontrolleve që ndërlidhen me inkasimin e të hyrave, pagesa para se të kryhen punimet, pagesat nga kodet jo adekuate ekonomike, etj.
- Rekomandimi 4** Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit të përcaktojë një afat kohor konkret për adresimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Implementimi i këtij plani duhet të rishikohet nga Kryetari i Komunës në mënyrë sistematike.

4 Qeverisja e përgjithshme

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Komuna nuk kishte bërë vetëvlerësim si dhe nuk kishte regjistër të rreziqeve.

Mirëpo, fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë: planifikimi dhe realizimi i buxhetit në investime kapitale, klasifikimi i shpenzimeve, raportimet e detajuara mbi progresin e investimeve kapitale, regjistrimet dhe raportimet e pasurive, dhe themelimi i sistemit të auditimit brendshëm.

4.1 Qeverisja e mirë

Çështja 6: Kontrollat menaxheriale - Prioritet i lartë

E gjetura Rishikimi që ne i kemi bërë kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar kryesor të komunës ka nxjerrë në pah dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë. Si të tilla, aranzhimet e përgjithshme të qeverisjes kërkojnë forcim, në veçanti në lidhje me: planifikimin dhe realizimin e buxhetit në investime kapitale (keq klasifikimet), raportimet e detajuara mbi progresin e investimeve kapitale, regjistrimet dhe raportimet e pasurive, mungesa e themelimit të NJAB, mungesa e dosjeve elektronike të personelit, si dhe vlerësimet e punëtoreve.

Po ashtu, shpenzimet e bëra në avans nga paratë e imta, nuk janë përcjellë me kërkesa dhe arsyetimet e duhura.

Mungesa e raportimeve të rregullta mbi mbarëvajtjen e operacioneve të përditshme të komunës ka shkaktuar dobësi domethënëse në menaxhim, që për pasojë kanë patur parregullsitë e identifikuara më lart.

Rreziku Cilësia e dobët e raportimit të brendshëm tek menaxhmenti i lartë redukton aftësinë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe dëmton kontrollin efektiv buxhetor.

Rekomandimi 5 Kryetari duhet të merr masa të shpejta dhe të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar dhe një sistem i zhvilluar i raportimit të brendshëm, përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për rezultatet, shpenzimet dhe mangësitë e kontrollit dhe krijimin e një bazë për menaxhimin aktiv të tyre.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Komunën e Mamushës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	1,272,609	1,401,944	1,301,902	1,051,000	1,057,000
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,209,609	1,285,920	1,264,363	973,000	1,003,000
Të bartura nga viti paraprak ²	0	30,478	0	58,000	48,000
Të hyrat vetanake ³	63,000	63,000	17,987	19,000	6,000
Donacionet e brendshme	0	5,150	5,150	1,000	0
Donacionet e jashtme	0	17,396	14,402	0	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 129,335€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve vendore dhe të jashtme (22,546€), të hyrave të bartura nga viti paraprak (30,478€), dhe rritja e grantit qeveritar (76,311€).

Në vitin 2014, Komuna e Mamushës ka shpenzuar 93% të buxhet final ose 1,301,902€, me një përmirësim prej 19% krahasuar me vitin 2013.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit (€)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Shpenzimi	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	1,272,609	1,401,944	1,301,902	1,051,000	1,057,000
Pagat dhe Mëditjet	710,000	786,311	784,127	682,000	694,000
Mallrat dhe Shërbimet	102,636	127,586	114,566	94,000	160,000
Shërbimet komunale	21,800	24,600	21,289	22,000	23,000
Subvencionet dhe Transferet	3,000	3,000	2,976	3,000	3,000
Investimet Kapitale	435,173	460,447	378,944	250,000	177,000

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

³ Të hyrat vetanake komunale të buxhetuara.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Pavarësisht rritjes në buxhetin për shpenzime kapitale gjatë vitit, vetëm 82% e buxhetit ishte shpenzuar.
- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje me 76,311€ dhe Mallra dhe Shërbime për 24,950€ është si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i mëparshëm.
- Pavarësisht kësaj, niveli i detyrimeve të papaguara ishte 25,400€.
- Ekzekutimi i buxhetit në vitin 2014 është 93%, që krahasuar me vitin 2013 (83%), vërehet një përmirësim të dukshëm.

Tabela 3. Të hyrat vetjake për buxhetin e Komunës - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	63,000	63,000	62,498	40,000	43,000

Të hyrat vetanake për këtë periudhë janë realizuar 99% nga shuma e planifikuar për vitin 2014, dhe kanë shënuar rritje prej 22,498 apo 36% në krahasim me të hyrat në vitin 2013.

Çështja 7: Ekzekutimi i buxhetit - Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Shkalla e ekzekutimit të buxhetit prej 93% paraqet një performancë të lakmueshme. Ekzekutimi i buxhetit i paraqitur është përafërsisht i ngjashëm ndërmjet viteve dhe nxjerr në pah një nivel pak më të ulët të ekzekutimit, tek investimet kapitale (82%). Një nivel i ngjashëm i shpenzimit ishte edhe në vitin 2013.
- Rreziku** Suficitet e buxhetit do të rezultojnë me shfrytëzim joefikas të burimeve financiare të komunës, si dhe reduktojnë efektivitetin e planeve të shpenzimeve për projektet kapitale të komunës.
- Rekomandimi 6** Kryetari duhet të inicioj një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me ngecjen e ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale në vitin 2014, dhe të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit për vitin 2015.

4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Përshkrimi

Të hyrat e mbledhura nga Komuna e Mamushës në vitin 2014 ishin në total 62,498€. Pjesa më e madhe e hyrave janë inkasuar nga tatimi në pronë në vlerë prej 27,629€ dhe taksat tjera administrative në vlerë prej 24,493€.

Komuna ka kontrole që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave. Megjithatë, ekziston një nevojë për përmirësim në disa procese për ta mbështetur saktësinë dhe plotësinë e mbledhjes së hyrave.

Çështja 8 - Mos azhurnimi i regjistrit të bizneseve dhe Inkasimi i dobët i të hyrave - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nga taksa për ushtrimin e veprimtarive të biznesit kishte inkasuar 2,206€. Regjistri i bizneseve që veprojnë në Komunë nuk është i azhurnuar. Sipas pohimeve të zyrtarëve për taksa komunale të bizneseve nuk ka një evidencë të saktë për numrin e bizneseve që operojnë në Komunën e Mamushës. Edhe pse Komuna kishte një program softuerik, sipas pohimeve të zyrtarëve ky program ishte jo funksional dhe nuk mund të gjeneroj raporte (kartela financiare) për taksapaguesit.

Ne kemi testuar 3 mostra dhe kemi vërejtur se komuna i kishte ngarkuar bizneset me taksa për ushtrimin e veprimtarisë afariste jo në pajtim me ngarkesën vjetore, siç parashihet me rregullore për taksa, tarifa, dhe ngarkesa komunale.

Komuna kishte kryer verifikimin e 1/3 e pronave të paluajtshme, si kërkohet me ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme nr.03/L-204 dhe udhëzimin administrativ në fuqi. Ne kemi vërejtur se komuna nuk ka arritur të azhurnoj sistemin me të dhëna sepse ka pasur vonesa në futjen në sistem të këtyre pronave dhe vetëm 44 prona janë futur në sistem.

Rreziku Mungesa e evidencës së saktë të bizneseve që operojnë brenda territorit të Komunës, programi softuerik jo funksional dhe ngarkesat jo në pajtim me rregulloren kanë rezultuar në dështim për të inkasuar taksa komunale nga bizneset që operojnë në territorin e komunës.

Mos regjistrimi i verifikimit të 1/3 së pronave ka ndikuar që Komuna mos të këtë të dhëna të sakta e të plota të pronës së tatueshme aktuale, me ndikimin e mundshëm që të hyrat e vlerësuara për tatimin në pronë të ulen.

Rekomandimi 7 Kryetari duhet të sigurojë që regjistri i bizneseve aktive të azhurnohet në baza të rregullta, të funksionalizoj programin softuerik dhe të vendos evedienca të sakta mbi numrin e bizneseve që i detyrohen Komunës. Vendimet për ngarkesa me taksa të jenë konform rregullores në fuqi të miratuar nga kuvendi i komunës, ndërsa verifikimi dhe regjistrimi i kërkuar i pronës së tatueshme të kryhet me kohë.

Çështja 9- Vonesa në depozitimet e parasë në bankë- Prioritet i mesëm

E gjetura Ne kemi vërejtur se ka vonesa të deponimit të parave në bankë, të inkasuara nga të hyrat vetjake. Paratë e inkasuara mbahen deri në 15 ditë në arkën e komunës dhe nuk dorëzohen në bankë.

Rreziku Mbajtja e parave të gatshme në arkat e komunës dhe mos deponimi i tyre me kohë në bankë, rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 8 Kryetari duhet të siguroj se gjitha paratë e gatshme nga taksat dhe inkasimet tjera nga qytetarët, brenda afateve të përcaktuara me ligj të deponohen në bankën më të afërt.

4.4 Shpenzimet

4.4.1 Prokurimi

Përshkrimi

Projektet e investimeve kapitale përgjithësisht iu janë përmbajtur tabelave buxhetore. Vetëm në një rast kemi hasur se për një projekt të caktuar, në mungesë të mjeteve i janë marrë mjetet projektit tjetër pa i ndjekur procedurat për ridestinim të mjeteve.

Çështja 10- Ekzekutimi i pagesave para përfundimit të punëve - Prioritet i lartë

E gjetura Kryetari kishte nënshkruar marrëveshje me Qendrën Rajonale për Mjedisin për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) për "Furnizim me kamion për pastrim të rrugëve", në vlerën 60,000€. Pjesëmarrja e Komunës ishte 20,000€ apo 33% të vlerës së projektit. Procedurat e prokurimit duhej t'i udhëheqte REC, dhe atë vetëm atëherë kur mjetet barten në llogarinë e REC-ut. Pagesa nga komuna ishte bërë me 02.07.2014 ndërsa kamioni ishte pranuar me 17.10.2014.

Shpenzimi për ndërtimin e ndërtesës administrative të komunës në vlerë prej 12,550€ me datën 30/12/2014 ishte ekzekutuar ende pa u përfunduar punët. Si kundërvlerë për këtë pagesë, OE i kishte ofruar komunës një sigurim për ekzekutimin e punimeve të konfirmuar nga banka.

Rreziku Pagesat e bëra në avanc nga komuna në llogari të donatorëve në bazë të marrëveshjes me operatorit ekonomik, pa situacione dhe pa raporte të pranimit të punëve, rrit rrezikun që mjetet e shpenzuara nga komuna të mos arrin efektin e synuar, madje as projektet të mos realizohen fare. Komuna nuk duhet t'i kreditoj bashkë financuesit sepse pagesat e tilla janë në kundërshtim me ligjin për LMFPP dhe rregullën e thesarit 01/2013 ku thuhet se shpenzimet nga kategoria e investimeve kapitale duhet të bëhet atëherë kur plotësohen këto dokumente si: kërkesa për blerje, kopja e kontratës që është nënshkruare nga zyrtari i prokurimit, urdhër blerja, raporti i pranimit, urdhër pagesa dhe fatura origjinale.

Rekomandimi 9 Kryetari duhet të sigurojë se nuk do të përsëritet një praktikë e tillë e financimit dhe se të gjitha pagesat do të bëhen vetëm pasi të jetë kompletuar dokumentacioni ashtu siç e parasheh ligji.

Çështja 11- Dobësi në kontrolle në zbatimin e kontratës- Prioritet i lartë

- E gjetura** Ne testuam përmbushjen e kontratës për ndërtimin e rrugëve lokale Mamushë me vlerë prej 34,556€ e lidhur me datën 16.06.2014. Gjatë testimit të dy pagesave kemi vërejtur se për disa artikuj nuk ishin respektuar çmimet e kontratës gjatë faturimit dhe komuna i kishte pranuar dhe paguar ato. Rastet kur çmimet në faturë janë më të larta se në kontratë janë: situacioni i parë pozicioni 3 është ofertuar me 0.10€ ndërsa është paguar me 0.30€, ndërsa situacioni i dytë pozicioni 8 është ofertuar me 0.10€ ndërsa është paguar me 0.30€ që gjithsej është paguar më tepër 1,251€.
- Rreziku** Dobësitë e identifikuara në kontrolle rrit rrezikun që të tejkalohet kontrata ose disa pozicione të kërkuara të mos përfundohen. Dështimi i kontrolleve të tilla i kushton komunës me humbje financiare të fondeve.
- Rekomandimi 10** Kryetarin duhet të siguroj një sistem efektiv të kontrollit në parandalimin e devijimeve nga kushtet kontraktuale si në pranimin e mallit ashtu edhe në pagesën e çmimeve për to. Rasti si më lart duhet të hetohet nëse ishte gabim, apo cilat ishin arsyet që kanë çuar deri te pagesat jo të ligjshme.

4.4.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Buxheti i final për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 786,311€, ndërsa shpenzimet janë 784,126€ apo 99.7%.

Për këtë kategori kemi audituar rekrutimet, orët për punë shtesë, zyrtarët që kanë ndërprerë marrëdhënien e punës, dhe pushimet e lehonisë.

Komuna nuk posedon regjistrin elektronik të punëtorëve por vetëm kopjet fizike, si dhe në dosje mungojnë vlerësimet e punëtorëve për vitin 2014.

Çështja 12- Angazhimi në punë pa konkurs publik - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në drejtorinë e arsimit janë angazhuar në punë dy mësimdhënës (zëvendësim), njëri për lëndën fizikë/kimi me datën 03/02/2014, dhe tjetri gjuhë angleze me datën 01/01/2014. Për këta dy mësimdhënës nuk na është ofruar dëshmi se është shpallur konkurs publik nga ana e komunës.
- Rreziku** Pranimi i mësimdhënësve pa shpalljen e konkursit publik, është tregues i nivelit të ultë të transparencës në procesin e rekrutimeve dhe rrit rrezikun që vendet e punës mund të mos u ofrohen kandidatëve më të mirë në mungesë të konkurrencës së hapur.
- Rekomandimi 11** Kryetari duhet të siguroj se të gjitha punësimet e mësimdhënësve të bëhen me konkurs publik, dhe në pajtim me ligjin e punës.

4.4.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve për vitin 2014 kishte planifikuar t'i shpenzoj 3,000€, ndërsa kishte shpenzuar 2,955€ apo 99%.

Ne kemi testuar 5 mostra në vlerë 1,155€ dhe kemi identifikuar çështjet në vijim:

Çështja 13- Mungesa e hartimit të rregullores për subvencione - Prioritet i lartë

- E gjetura** Komuna nuk ka rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve. Në mungesë të saj, subvencionet janë ndarë në bazë të vendimeve të kuvendit të komunës.
- Rreziku** Mungesa e rregullores së brendshme, rrit rrezikun që dhënia e subvencioneve të bëhet pa proceduara dhe kriteret.
- Rekomandimi 12** Kryetari duhet të hartoj një rregullore dhe të aprovohet në kuvend, e cila specifikon qartë kriteret, procedurat për subvencionim.

4.5 Pasuritë dhe detyrimet

4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurive në Komunë vazhdon të mbetet sfidë. Komuna nuk ka bërë regjistrimin e pasurive mbi 1,000€ në SIMFK dhe regjistrimet e pasurive nën 1,000€ në programin E-pasuri, ndërsa kishte vetëm një regjistër të brendshëm në formën e Excel-it.

Çështja 14- Regjistrimet në SIMFK dhe E -Pasuria- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna nuk kishte filluar me regjistrimin kontabël të pasurisë në (SIMFK) për pasuritë që kanë vlerë mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit më të gjatë se një vit, pasi që kjo komunë ende nuk ka ndonjë zyrtar të pasurisë. Po ashtu, zyrtari i pranimit nuk bën regjistrimin e blerjeve në regjistrat kontabël që duhet t'i mbajnë organizatat buxhetore në programin E-pasuria.

Rreziku Mungesa e regjistrave të pasurive vështirëson identifikimin e pasurive për të konfirmuar ekzistencën e tyre dhe vlerën e pasurive që ka në posedim komuna, si dhe rrit rrezikun që ato të keqpërdoren, madje edhe të humben apo tjetërsohen.

Rekomandimi 13 Kryetari duhet të ndërmerr masa në caktimin e zyrtarit të pasurisë. Pas caktimit të zyrtarit të fillohet menjëherë me regjistrimet e pasurive pajtim me rregulloren Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare.

4.5.2 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk kishte nxjerr dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë dhe taksa për ushtrimin e veprimtarisë.

Çështja 15- Trajtimi i llogarive të arkëtueshme -Prioritet i lartë

E gjetura Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të dhënave nga komuna përbëjnë shumën e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 165,811€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë në biznes, në vlerë prej 90,930€, dhe tatimi në pronë prej 74,881€.

Rreziku Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu, mund të rezultojë në vështirësi të mëtutjeshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.

Rekomandimi 14 Kryetari duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

4.5.3 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Komuna ka arritur të menaxhoj mirë me borxhet. Konkludimet tona të auditimit janë se trajtimi i borxheve dhe kontrollet ndaj tyre përgjithësisht funksionojnë mirë.

Pasqyra e detyrimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2014 ishte në shumë prej 25,412€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015. Detyrimet për mallra dhe shërbime 18,545€, ndërsa për komunal 5,666€ dhe subvencione 1,200€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.6 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Sistemi i auditimit të brendshëm dhe komiteti i auditimit janë pjesa kyçe e kontrollit të brendshëm, prandaj mos ekzistimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) si pjesë e rëndësishme kontrollit të brendshëm rezulton në mangësia në ofrimin e sigurisë sa i përket përmbushjes të Komitetit Auditimit mos përmbushjen e qëllimeve të menaxhmentit të komunës.

Çështja 16- Mungesa e sistemit të Auditimit të Brendshëm- Prioritet i lartë

E gjetura Komuna e Mamushës nuk e ka të themeluar NJAB.

Rreziku Mungesa e auditimit të brendshëm i kufizon menaxhmentit mundësinë të ketë pamje të qartë mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrolleve.

Rekomandimi 15 Kryetari duhet të siguroj themelimin e NJAB dhe komiteti i auditimit në pajtim me ligjin nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm, të kërkoj zgjidhje për ofrimin e shërbimeve të tilla.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për ‘Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit’.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
2. Pasqyrat Financiare	Ne PVF të prezantohen gjitha shpalosjet e duhura.		Pjesërisht.	
3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryetari duhet të sigurojë që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të dhëna, duke identifikuar stafin përgjegjës dhe duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht	
4.3 Planifikimi dhe realizimi i hyrave	Kryetari duhet të monitorojë në mënyrë sistematike performancën buxhetore në baza mujore dhe të identifikojë dhe adresojë barrierat për të planifikuar nivelet e ekzekutimit të buxhetit.		Pjesërisht.	
4.4 Te hyrat	Përmirësimi i procedurave të lidhura me këto sisteme do të mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë risqe të mëdha dhe të sigurojë që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet.		Pjesërisht.	
4.5 Shpenzimet	Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se komuna do të ndërmarrë hapa të mëtjeshëm për përmirësimin e kontroleve mbi shpenzimet dhe pagesat, dhe të sigurojë se i gjithë informacioni i kërkuar është paraqitur në mënyrë rigoroze në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.		Pjesërisht	
4.5.3 Pagat dhe mëditjet	Kryetari të sigurohet se komuna mban dosje të plota lidhur me të punësuarit e saj.		Pjesërisht	

4.5.4 Subvencionet dhe Transferet	Komuna duhet të ndërtojë procedura kontrolli të përshtatshme të mjaftueshme, për monitorimin efektiv mbi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, në lidhje me subvencionet dhe transferimet.			I pa adresuar
4.6 Pasuritë	Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e aseteve të komunës dhe të sigurohet se në mënyrë të vazhdueshme komuna regjistron dhe prezanton në pasqyrat e saj financiare të gjitha pasuritë, si edhe barazon informatat nga të gjitha burimet e përfshira në financimin e pasurive.			I pa adresuar
Pagesat e palëve të treta	Kryetari të sigurohet se komuna po bën përpjekjet maksimale për sigurimin e të dhënave nga palët e treta me theks të veçantë tek ato palë që kanë kryer investime të rëndësishme në komunë.	Plotësisht i adresuar		
4.6.2 Trajtimi i parasë së gatshme	Kryetari të sigurohet se do të depozitohen dhe kontrollohen rregullisht paratë në fund të çdo dite.			I pa adresuar
4.6.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Kryetari të sigurojë se do të dizajnohet dhe do të ndërtohet një proces i cili do të bëjë të mundur që të arkëtueshmet do të regjistrohen gjatë lëshimit të çdo fature dhe që shumat e mbetura do të ndiqen rregullisht.			I pa adresuar
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	Komuna nuk ka krijuar Departamentin e Auditimit të Brendshëm dhe Komitetin.			I pa adresuar